



Н.У. ЦЕНТАР ЗА КУЛТУРА "ИЛО АНТЕСКИ СМОК"-ТЕТОВО
I.N. QENDRA E KULTURËS "ILO ANTESKI SMOK"-TETOVË
N.I. CENTER OF CULTURE "ILO ANTESKI SMOK"-TETOVA

RAPORTI VJETOR

PËR PUNË DHE PUNËN
FINANCIARE

2020

TETOVË, 2021

Në bazë të nenit 31-b, paragrafi (1) i Ligjit për Kulturë (“Fletorja zyrtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut” 44/2014) dhe nenit 12, pika 10 e Statutit të INQK “Ilo Anteski Smok”-Tetovë, nr. 0101-18/6 miratuar më datë 16.04.2015, Drejtori i Institucionit Nacional Qendra për kulturë “Ilo Anteski-Smok”- Tetovë, paraqet:

**RAPORT VJETOR PËR PUNË DHE PUNËN FINANCIARE TË INSTITUCIONIT
NACIONAL QENDRA PËR KULTURË
„ILO ANTESKI SMOK”-TETOVË
PËR PERIUDHËN 01.01.2020-31.12.2020**

**TETOVË
2021**

Përmbajtja:

Hyrje.....	4
I. Organet udhëheqëse dhe drejtuese.....	5
I.1. Organ udhëheqës Drejtori.....	5
I.2. Organ drejtues Këshilli drejtues.....	5
II. Pagesa të realizuara dhe boxhe të shlyera.....	5
III. Pjesa programore.....	6
III.1. Aktivitetet.....	6
III.2. Raport narativ.....	8
IV. Raporti financiar	13
Përfundimi	17

HYRJE

Qendra për Kulturë „Ilo Anteski-Smok”-Tetovë është ndërtuar në vitin 1973, ndërsa administrata zyrtarisht me punë filloi në vitin 1975. Objekti ka sipërfaqe prej 6500 m², nga e cila 780 m² janë pjesë e skenës.

Për organizim të aktiviteteve skenike, Qendra për kulturë posedon sallë të madhe me 661 ulëse, si dhe sallë të vogël me 50 ulëse për promovime të ndryshme.

Qendra për kulturë është institucion i rëndësishëm për kulturën, aktivitetet kulturore dhe skenike, të cilat realizohen në qytetin e Tetovës dhe rrethinën në përgjithësi. E gatshme për organizim të koncerteve, aktiviteteve të ndryshme muzikore dhe skenike, shfaqje, promovime, ekspozita, koncerte të ansambleve, mbajtje të aktiviteteve politike dhe njëkohësisht me veprimet e veta në mënyrë aktive vepron në promovimin dhe realizimin e vlerave kulturore.

Për çdo vit në këtë objekt aktivitetet e tyre i zhvillojnë qindra aktorë të profileve të ndryshme nga të gjitha nacionalitetet dhe gjuhë të ndryshme, aktorë, muzikantë, këngëtarë, kore, fotograf. Në qendrën për kulturë në vit organizohen mbi 100 aktivitete me mbi 50.000 vizitorë.

I. ORGANET UDHËHEQËSE DHE DREJTUESE

I.1. ORGAN UDHËHEQËS DREJTORI

Institucioni Nacional qendra për kulturë “Ilo Anteski-Smok”-Tetovë, udhëhiqet nga drejtori. Drejtorin e zgjedh ministri i kulturës me konkurs publik të shpallur nga Ministria e Kulturës dhe me mandat 4 vjeçar, me të drejtë rizgjedhje. Drejtori i institucionit për periudhën nga 01.01.2020-31.12.2020 vit, ka udhëhequr, koordinuar dhe ka eliminuar të gjitha pengesat e mundshme, për realizim efikas të aktiviteteve amë, aktiviteteve që organizohen nga shoqata si dhe institucione të ndryshme.

I.2. ORGAN DREJTUES KËSHILLI DREJTUES

Këshillin drejtues të Qendrës për kulturë e përbëjnë 5 (pesë) anëtarë të cilët i emëron dhe shkarkon ministri i kulturës, nga të cilët dy janë nga radha e përfaqësuesve nga sfera e kulturës, një është nga pushteti vetë administrimit lokal dhe dy përfaqësues nga të punësuarit në Qendrën për kulturë. Këshilli Drejtues në periudhën nga 01.01.2020-31.12.2020 vit, ka realizuar gjithsej 5 (pesë) seanca, të dhëna në mënyrë tabelore.

Data e seancave	Vendime	Pëlqime	Miratime
14.02.2020	1	/	/
28.02.2020	/	/	1
23.07.2020	/	1	/
28.08.2020	/	3	/
01.10.2020	/	/	1
Gjithsej:	5	1	4

II. PAGESA TË REALIZUARA DHE BORXHE TË SHLYERA

INQK. „Ilo Anteski Smok”-Tetovë, gjatë periudhës 01.01.2020 deri më 31.12.2020 nuk ka pasur pagesa të realizuara ose borxhe të shlyera nëpërmjet procedurave për përmbarim.

III. PJESA PROGRAMORE

III.1. AKTIVITETET

INQK “Ilo Anteski-Smok”- Tetovë, në objektin e vet për paraqitje të aktiviteteve të ndryshme ka sallën e madhe me kapacitet prej 661 ulësesh dhe sallën e vogël të përshtatshme për promovime të ndryshme me 50 ulëse.

Në periudhën prej 01.01.2020 deri më 31.12.2020, për shkak të gjendjes së jashtëzakonshme në Republikën e Maqedonisë së Veriut si dhe në shumë shtete tjera në botë, në përputhje me konkluzionet, masat dhe rekomandimet e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut, për parandalim të përhapjes së COVID-19 (korona virusit), të gjithë aktivitetet e parapara pas 11 marsit deri në 15 qershor janë anuluar. Deri në fund të vitit në Qendrën për kulturë, gjithsej janë realizuar vetëm njëzet aktivitete. Në këto aktivitete, në Qendrën për Kulturë kanë frekuentuar 2,880 dashamirë të artit të të gjitha kombësive dhe religjioneve në vend.

Aktivitetet të ndara sipas llojit për periudhën 01.01.2020–31.12.2020 në mënyrë tabelare duket kështu:

NR.	LLOJI I AKTIVITETIT	NUMRI I AKTIVITETEVE
1.	Shfaqje	4
2.	Muzikë klasike dhe balet	2
3.	Folklor	2
4.	Ekspozita	6
5.	Panaire	0
6.	Tribuna	2
7.	Takime politike	0
8.	Muzikë argëtuese	0
9.	Aktivitete për fëmijë	0
10.	Aktivitete humanitare	0
11.	Film	3
12.	Veprimtari letrare	1
	Gjithsej	20

Sipas kategorisë së moshës:

Nr.	Kategoria e moshës	Gjithsej aktivitete	Gjithsej shikueshmëri
1.	deri 12	1	30
2.	+12	1	150
3.	+18	18	2,700
Gjithsej		20	2,880

Aktivitete sipas bazës nacionale:

Nr.	Aktivitet sipas përkatësisë nacionale	Gjithsej aktivitete	Gjithsej shikueshmëri
1.	E përzier	7	550
2.	Shqiptare	11	2,030
3.	Maqedonase	2	300
4.	Serbe	0	0
5.	Turke	0	0
6.	Rome	0	0
Gjithsej		20	2,880

Qendra për Kulturë ka të lidhur kontrata me të gjithë organizatorët, përveç Teatrit të Tetovës, me të cilët jemi nën një kulm. Gjithashtu, duhet të theksojmë se Qendra e Kulturës ka të lidhura kontratë pa pagesë për sallën e madhe dhe foajenë, sipas pëlqimit të marrë nga Qeveria e R. të Maqedonisë dhe Ministrisë së Kulturës për lirim nga pagesa

Nr.	Kontrata të lidhura	Lirim nga pagesa	Vlera
1.	Me leje nga Ministria e Kulturës dhe Qeveria		
2.	Teatri i Tetovës	(72 ditë)	
Gjithsej			denarë

III.2. RAPORT NARATIV

Janar 2020

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
film	Produksioni HI Media	30.01.2020	300

- 01) 30.01.2020 (e enjte) – Në organizim të produksionit “HI Media” u mbajt premiera e filmit Falco në regji të Bes Kallakut. Në aktivitet morën pjesë 300 shikues.

Shkurt 2019

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
ekspozitë	Ambasada e Iranit Qendra për kulturë Tetovë	14.02.2020	150
shfaqje	Produksioni Zllaten Zab	19.02.2020	250

- 01) 14.02.2020 (e premte) – Në hapësirat e foajesë në organizim të Ambasadës së Iranit dhe Qendrës për Kulturë “Ilo Anteski Smok” Tetovë, u mbajt ekspozita personale “Kaligrafi të profesorit të mirënjohur nga Irani Mohamed Reza Afsharit”. Ekspozitën e vizituan 150 veta.
- 02) 19.02.2020 (e mërkurë) - Në hapësirat e sallës së madhe në organizim të produksionit “Zllaten Zab” u realizua Stand Up komedija e Semir Giciç dhe Ivana Naskovës. Aktivitetin e ndoqën 250 të pranishëm.

Korrik 2020

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
/	/	/	/

- Teatri i Tetovës ka shfrytëzuar sallën gjithsej 10 ditë.

Gusht 2020

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Koncert	Shoqata "Artal"	06.08.2020	150
		10.08.2020	
		12.08.2020	
Koncert	Shoqata "Artal"	18.08.2020	50
Ekspozitë	Qendra për Kulturë	29.08.2020	150

- Teatri i Tetovës ka shfrytëzuar sallën gjithsej 8 ditë.

01) (06,10,12.08.2020) – Në organizim të Shoqatës "Artal" – Tetovë, u realizua festivali ndërkombëtar "Meridians". Për shkak të pandemisë prania e mysafirëve ishte reduktuar me gjithsej 150.

02) 18.08.2020 – (e martë) - Në organizim të Shoqatës "Artal" – Tetovë, u realizua koncerti "Hijet në pentagram". Për shkak të pandemisë numri i artdashësve u reduktua në 50.

03) 29.08.2020 – (E shtunë) – Në organizim të Qendrës për Kulturë u mbajt ekspozita kolektive e titulluar si "Ekspozitë kolektive e arkitekturës së vjetër dhe dizajnit". Në aktivitet morën pjesë më shumë se 15 artistë, ndërkaq kishte më shumë se 150 vizitorë. Projekti ishte i mbështetur nga Ministria e Kulturës.

Shtator 2020

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Shfaqje	Teatri i Tetovës	04-05.09.2020	150
Ekspozitë	Shoqata “Purpura”	04.09.2020	50
Ekspozitë	Qendra e Kulturës	13.09.2020	150

01) Teatri i Tetovës ka shfrytëzuar sallën gjithsej 11 ditë, ndërkaq u shfaq edhe premiera e shfaqjes operistike “Opera për tre groshë”, në regji të Qëndrim Rijanit. Në shfaqje sipas protokollit pati 150 artdashës.

02) 04.09.2020 – (e mërkurë) – Në organizim të Shoqatës “Purpura” – Tetovë, u realizua ekspozita për fëmijët me autizëm, e përgatitur nga Nevzat Kica. Ndërsa pas ekspozitës u realizua duo koncerti nga Shkëlzen Pajaziti dhe Shkëlzen Baftjari. Në aktivitet morën pjesë 50 persona sipas protokollit.

03) 13.09.2020 – (E diel)- Në organizim të Qendrës për Kulturë u mbajt ekspozita kolektive e titulluar “Pa titull”. Në aktivitet morën pjesë rreth 15 artistë dhe kishte mbi 150 vizitorë. Projekti ishte i përkrahur nga Ministria e Kulturës.

Tetor 2020

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Shfaqje	Teatri i Tetovës	08-09.10.2020	150
Film	TIFF “Oda”	08-15.10.2020	400
Letërsi	MNL “Ditët e Naimit”	17.10.2020	50
Tribunë	Shoqata e pedagogëve shqiptarë	21.10.2020	150
Ekspozitë	Qendra e Kulturës	23.10.2020	150

Film	Teatri i Tetovës	24.10.2020	50
Folklor	SHKA “Xheladin Zeqiri”	25.10.2020	Online
Shfaqje	Shoqata “Purpura”	28.10.2020	30
Ekspozitë	Qendra e Kulturës	29.10.2020	50

- 01) Teatri i Tetovës ka shfrytëzuar sallën gjithsej 13 ditë, në të cilën e përgatitën premierën e shfaqjes “Epshe dhe lakmi”, në regji të Fitim Selimit. Në ngjarje sipas protokollit të KOVID-19, morën pjesë 150 artdashës. Premiera u dha më 08.10.2020, ndërsa repriza më 09.10.2020.
- 02) (08.10.2020 – 15.10.2020) – U mbajt edicioni i 9-të i festivalit ndërkombëtar të filmit TIFF Oda. U paraqitën më se 50 filma të metrazhit të shkurtë dhe të gjatë me produksione nga e gjithë bota.
- 03) 17.10.2020 – (E enjte) – U mbajt edicioni i 24 i Festivalit Ndërkombëtar të Poezisë “Ditët e Naimit”, në të cilën morën pjesë poetë nga vendi dhe rajoni, që për shkak pandemisë nuk mundej të shtrihej edhe më gjerë. Në aktivitet morën pjesë rreth 50 artdashës.
- 04) 21.10.2020 – (E mërkurë) – Shoqata e Pedagogëve shqiptarë, mbajti akademi solemne me rastin e 7-marsit ditës së mësuesit, por që për shkak pandemisë u prolongua deri më tetor. Në aktivitet morën pjesë 150 vizitues.
- 05) 23.10.2020 – (E premte) – Në organizim të Qendrës për Kulturë u mbajt ekspozita individuale e Zabedin Memishit e titulluar “Kaosi në qiell”. Në aktivitet morën pjesë 150 vizitorë. Projekti ishte i mbështetur nga Ministria e Kulturës.
- 06) 24.10.2020 – (E shtunë) – Në organizim të Teatrit të Tetovës u dha premiera e filmit me metrazh të gjatë “Përvoja të njëjta nga perspektiva të ndryshme”, të regjisorit Senad Abduli. Në ngjarje morën pjesë dhe ministresha e kulturës Irena Stefoska.
- 07) 25.10.2020 – (e diel) – Në organizim të SHKA “Xheladin Zeqiri”, u mbajt koncert vjetor, që për shkak pandemisë u shfaq online.
- 08) 28.10.2020 – (e mërkurë) – Në organizim të Shoqatës “Purpura”, u realizua një shfaqje edukuese për fëmijët me pengesa, në regji të Levko Bogdanovskit. Në aktivitet pat 30 fëmijë duke iu përmbajtur protokollit të KOVID 19.

09) 29.10.2020 – (e enjte) – Në organizim të Qendrës për Kulturë u mbajt ekspozita e piktorit Bilgaip Koçishta. Në aktivitet morën pjesë 50 vizitorë.

Nëntor 2020

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Tribunë	Aleanca e Luftëtarëve	03.11.2020	online
Ekspozitë	Qendra e Kulturës	26.11.2020	150

- Teatri i Tetovës ka shfrytëzuar sallën gjithsej 8 ditë.

01) 03.11.2020 – (E martë) – Në organizim të Aleanca e Luftëtarëve, u mbajt akademi përkujtimore në kushte online.

02) 26.11.2020 – (E enjte) – Në organizim të Qendrës për Kulturë u mbajt ekspozita individuale e Muhamet Idrizit e titulluar “Impresione abstrakte”. Në aktivitet morën pjesë 150 vizitorë. Projekti ishte i mbështetur nga Ministria e Kulturës.

Dhjetor 2020

Veprimtaria	Organizator	Data	Të pranishëm
Folklor	ASHKVSH	18.12.2020	150

- Teatri i Tetovës ka shfrytëzuar sallën gjithsej 7 ditë.

01) 18.12.2020 – (E premte) – Ansambli Shtetëror i Këngëve dhe valleve shqiptare, mbajti koncert vjetor, pas turnesë disaditore nëpër qytetet e Maqedonisë, duke përfunduar në Tetovë. Në ngjarje sipas protokollit morën pjesë 150 artdashës.

IV. RAPORTI FINANCIAR

Periudha prej 01.01.2020 deri më 31.12.2020

TË DALAT, ZËRI 401 - RROGA BAZË

Të punësuarit të cilët me aktivitetin e tyre kontribuojnë për realizimin e programit vjetor të institucionit, vlera për pagat dhe tatimin personal është 6,173,405.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 402 – KONTRIBUTET E SIGURIMIT SHOQËRORË

Detyrimet të cilat rrjedhin nga pagesa e borxheve kundrejt puntorëve për kontributet janë në vlerën gjithsej 2,396,275.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 421 – SHËRBIMET KOMUNALE, NXEMJA, KOMUNIKACIONI DHE TRANSPORTI

Shpenzimert e Qendrës për Kulturë të energjisë elektrike për 6500 m² të hapsirë shfrytëzuese, dhe atë që e shfrytëzon infrastruktura dhe institucionet e tjera si: Teatri i Tetovës, Këndi Amerikan (American Corner Tetovo) janë në vlerë gjithsej 1,003,232.00 denarë. Aktivitetet e liruara nga pagesa nga ana e Ministrisë së Kulturës ndikojnë mbi buxhetin e Qendrës për Kulturë, dyfish më shumë sepse zhvillohen gjatë kohës kur kërkesat për aktivitete janë më të mëdha. Shpenzimet për energji elektrike, ujësjellësi dhe kanalizimi, taksa dhe shërbime tjera komunale, materiale tjera për ngrohje, posta, telefon, janë gjithsej në vlerë prej 1,998,267.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 425 – SHËRBIMET KONTRAKTUESE

Vlera e këtij zëri për pagesë të aktiviteteve shtesë dhe shërbime të tjera kontraktuese është 57,886.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 426 – SHPENZIMET TJERA NË VIJIM

Në këtë kategori të të dalurave, shpenzimet për shpallje publike janë në vlerë gjithsej 1,416.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 464 – TRANSFERE TË NDRYSHME

Vlera e këtij zëri për qëllime programore dhe për angazhim të bashkëpunorëve të jashtëm me kontratë në vepër është gjithsej 2,205,769.00 denarë.

TË DALAT, ZËRI 482 – OBJEKTE TJERA NDËRTIMORE

Në ciklin e investimeve në të cilin përfshihet institucioni jonë si bartës i ndërtimit të objektit të Institucionit Kombëtarë Teatri dhe Biblioteka e Tetovës, në perputhje me Konkluzionin e Qeverisë së Republikës së Maqedonisë së Veriut Nr. 42-17/184, për periudhën prej 01.01.2020 deri më 31.12.2020 janë realizuar gjithsej denarë. Për kryerjen e mbyqirjes së objektit të Teatrit dhe Bibliotekës së Tetovës shpenzimet janë në vlerë prej 82,244,308.00 denarë. Për kryerjen e mbyqirjes së objektit të Teatrit dhe Bibliotekës së Tetovës shpenzimet janë në vlerë prej 35,400.00 denarë. Vlera gjithsej e këtij zëri është 82,279,708.00 denarë.

Bashkangjitje: Paraqitja tabelare e Raportit financiar të I.N.Q.K „Ilo Anteski-Smok”-Tetovë.

I. TË HYRAT

ZËRI	PËRSHKRIMI I ZËRIT	VLERA (DENARË) ZËRI 603	VLERA (DENARË) ZËRI 631	VLERA (DENARË) ZËRI 787	VLERA (DENARË) ZËRI 785	GJITHSEJ
723911	Qeraja nga objektet	0.00	308,297.00	454,889.00	0.00	763,186.00
741112	Transfere nga buxheti R.M	94,249,445.00	0.00	0.00	0.00	94,249,445.00
744111	Donacione nga kompanitë private	0.00	0.00	0.00	160,285.00	160,285.00
GJITHSEJ TË HYRA		94,249,445.00	308,297.00	454,889.00	160,285.00	95,172,916.00

II. TË DALAT

ZËRI	PËRSHKRIMI I ZËRIT	VLERA (DENARË) ZËRI 603	VLERA (DENARË) ZËRI 631	VLERA (DENARË) ZËRI 787	VLERA (DENARË) ZËRI 785	GJITHSEJ
401	RROGA BAZË	6,173,405.00	0.00	0.00	0.00	6,173,405.00
401130	Rroga bazë	5,756,762.00	0.00	0.00	0.00	5,756,762.00
401310	Tatimi personal i të ardhurave të rrogës	416,643.00	0.00	0.00	0.00	416,643.00
402	KONTRIBUTET E SIGURIMIT SHOQËRORË	2,396,275.00	0.00	0.00	0.00	2,396,275.00
402110	Kontributet bazë të SPI	1,608,510.00	0.00	0.00	0.00	1,608,510.00
402210	Kontributet bazë të shëndetësisë	642,090.00	0.00	0.00	0.00	642,090.00
402220	Kontributet personale shtesë	42,834.00	0.00	0.00	0.00	42,834.00
402310	Kontributet bazë të entit per punsim	102,841.00	0.00	0.00	0.00	102,841.00
421	SHËRBIMET KOMUNALE, NXEMJA, KOMUNIKACIONI DHE TRANSPORTI	1,950,595.00	19,524.00	28,148.00	0.00	1,998,267.00
421110	Energjia elektrike	1,003,232.00	0.00	0.00	0.00	1,003,232.00
421120	Ujësjiellësi dhe kanalizimi	74,980.00	0.00	0.00	0.00	74,980.00
421190	Taksa dhe shërbime tjera komunale	86,692.00	0.00	0.00	0.00	86,692.00
421290	Materila tjera për ngrohje	785,691.00	0.00	0.00	0.00	785,691.00
421310	Posta	0.00	7,683.00	768.00	0.00	8,451.00
421320	Telefon dhe telefaks	0.00	11,841.00	27,380.00	0.00	39,221.00

425	SHËRBIME KONTRAKTUESE	0.00	0.00	57,886.00	0.00	57,886.00
425740	Aktivitete shtesë	0.00	0.00	20,000.00	0.00	20,000.00
425990	Shërbime tjera kontraktuese	0.00	0.00	37,886.00	0.00	37,886.00
426	SHPENZIME TJERA RRJEDHËSE	0.00	1,416.00	0.00	0.00	1,416.00
426410	Publikim i thirjes	0.00	1,416.00	0.00	0.00	1,416.00
464	TRANSFERE TË NDRYSHME	1,449,462.00	242,922.00	353,386.00	159,999.00	2,205,769.00
464990	Transfere tjera	1,449,462.00	242,922.00	353,386.00	159,999.00	2,205,769.00
482	OBJEKTE TJERA NDËRTIMORE	82,279,708.00	0.00	0.00	0.00	82,279,708.00
482920	Ndërtimi i objekteve tjera	82,279,708.00	0.00	0.00	0.00	82,279,708.00
GJITHSEJ TË HYRA		94,249,445.00	263,862.00	439,420.00	159,999.00	95,112,726.00

I	GJITHSEJ TË HYRA	95,172,916.00
II	GJITHSEJ TË DALA	95,112,726.00
	FITIMI NETO I REALIZUAR MBI TE HYRAT	60,190.00

PËRFUNDIMI

Si përmbledhje e gjithçkaje të lartëpërmendur mund të përmend elementet e mëposhtme:

- Periudha prej më 01.01.2020 – 31.12.2020 Qendra për Kulturë e përfundon me bilans pozitiv të suksesit;
- Planifikimet financiare të shpenzimeve tre mujore te Qendrës për Kulturë nuk janë respektuar plotësisht nga Ministria e Kulturës;
- Të gjendet zgjidhje për menaxhimin reciprok me Teatrin e Tetovës për shpenzimet dhe të hyrat për mirëmbajtjen dhe shfrytëzimin e të gjithë infrastrukturës tonë.
- Të sigurohen fonde financiare nga Ministria e Kulturës për shpenzimet themelore për mirëmbajtjen e vazhdueshme të objektit (renovimi dhe fondet themelore për mirëmbajtjen e higjienës).

I.N.Q.K. “Ilo Anteski-Smok”
Drejtore

M-r Arlind Husei

